



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË PARTIVE POLITIKE/SUBJEKTEVE
ZGJEDHORE, KONTROLLIN DHE VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE SHPENZIMEVE TË TYRE GJATË
FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pika 1, shkronja “f”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të nxjerrë rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, rolin dhe përgjegjësitë e financierëve të subjekteve zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e pavarur të tyre, si dhe për hetimin administrativ të informacioneve, kërkesave, propozimeve, ankesave apo denoncimeve për shkeljet lidhur me financimin apo shpenzimet e fushatës.

Neni 63, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, të sipërpërmendur, përcakton se subjekti zgjedhor, është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, si dhe mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për

deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish.

Neni 92/1, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, parashikon financimin e subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike, kufizimet e dhurimeve që çdo person juridik apo fizik vendas mund t'i japë një subjekti zgjedhor si dhe ndalimet e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

Nenet 92/2, dhe 92/3, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, përcaktojnë regjistrimin e fondeve jopublike nga çdo subjekt zgjedhor, të cilët duhet të regjistrojnë në një regjistër të posaçëm, të miratuara me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituar për çdo person fizik apo juridik si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit apo kredidhënësit, nënshkrimin e deklaratës, e cila nënshkruhet në çastin e dhurimit si dhe deklarimi dhe publikimi i raportit financiar për fushatën zgjedhore që çdo subjekt zgjedhor është i detyruar të paraqes në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Neni 92/6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, përcakton auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga ekspertë kontabël të licensuar dhe të përzgjedhur nga KQZ-ja.

Në zbatim të neneve 20, pika 1, shkronja "f", 92/1, 92/2, 92/3 dhe 92/6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, është hartuar projektvendimi "Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore".

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Objekt i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave të veçanta për plotësimin, depozitimin, kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare që dorëzojnë partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni përfshirë kandidatën për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumëmemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit; mënyrën e raportimi sipas formateve të përcaktuara për partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumëmemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit; miratimin e modeleve si dhe mënyrën e raportimit të raportit të auditimit nga ekspertët kontabël të licensuar të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të kontrolluar raportet financiare për fushatën zgjedhore të partive politike/subjekteve zgjedhore të përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi; afatet për publikimin e raporteve; përcaktimin e rolit dhe të përgjegjësisë të financierëve të partive politike/koalicioneve, si dhe të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit të përcaktuar në këtë vendim.

Risitë në këtë projektvendim:

- Formati i standardizuar i projektraportit të auditimit;
- Raportimi online i formateve financiare për fushatën zgjedhore;
- Raportimi online i formateve për projekt raportin si dhe raportin përfundimtar të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike/subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore;
- Detyrimet dhe përgjegjësitë e dorëzimit të raportit financiar për kandidatët në rastin kur propozohen nga koalicioni;
- Përgjegjësitë e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton dhe

miraton projektvendimin “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Majlinda CELMETA - Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme të Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKT V E N D I M

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË PARTIVE POLITIKE/SUBJEKTEVE
ZGJEDHORE, KONTROLLIN DHE VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE SHPENZIMEVE TË TYRE GJATË
FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja "f", 63, pikat 1 e 2, 92/1, 92/2, 92/3 dhe 92/6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KOMISIONI RREGULLATOR

V E N D O S:

Neni 1

Objekti

Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave për raportimin financiar për fushatë zgjedhore të subjekteve zgjedhore përfshirë kandidatët e listave shumemërore, kandidatët për kryetar bashkie, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, miratimin e modeleve të dokumentacionit që do të përdoret me këtë rast.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



"Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore"

Neni 2

Raporti financiar për fushatë zgjedhore

1. Raporti financiar për fushatë zgjedhore i subjektit zgjedhor përmban informacion të hollësishëm për:
 - a. burimet e financimit;
 - b. shpenzimet;
 - c. subjektet e lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që kontrollohen prej tyre, të cilat deklarohen nga vetë partia politike.
 - d. Bilancin e asetëve dhe detyrimeve për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, sipas modelit KQZ 03-12, shtojca nr. 9 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Raporti financiar për fushatë zgjedhore përfshin periudhën 6 muaj para datës së zgjedhjeve për çdo dhurim, hua ose kredi si dhe çdo shpenzim të bërë për qëllime të fushatës zgjedhore. Raporti financiar për fushatë zgjedhore i partisë politike hartohet dhe plotësohet sipas modeli KQZ 03-08, shtojca nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Raporti financiar për fushatën zgjedhore për kandidatët e listave shumëmemërore hartohet dhe plotësohet sipas modelit KQZ 03-09, shtojca nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Raporti financiar për fushatën zgjedhore për kandidatët për kryetar bashkie hartohet dhe plotësohet sipas modelit KQZ 03-10, shtojca nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Raporti financiar për fushatë zgjedhore për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit hartohet dhe plotësohet sipas modelit KQZ 03-11, shtojca nr. 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 3

Dorëzimi i raportit financiar për fushatë zgjedhore

1. Subjektet zgjedhore kanë detyrimin të dorëzojnë në KQZ raportin financiar të fushatës zgjedhore brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar. Raporti financiar i partisë politike pjesëmarrëse në zgjedhje duhet të jetë i nënshkruar nga kryetari i partisë politike ose personi i autorizuar nga ky i fundit dhe nga financieri i saj.
2. Në rastin e koalicionit, detyrimin dhe përgjegjësinë e dorëzimit të raportit financiar për kandidatët e ka partia udhëheqëse e koalicionit. Raporti financiar duhet të jetë i nënshkruar nga

kryetari i partisë politike udhëheqëse të koalicionit ose personi i autorizuar nga ky i fundit dhe nga financieri i saj.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u mundëson subjekteve zgjedhore dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF), e cila gjendet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ëëë.kqz.gov.al
4. Plotësimi dhe dorëzimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar bëhet sipas procedurave të parashikuara në Aktin përkatës të miratuara nga KQZ.
5. Raporti financiar i fushatës zgjedhore publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së jo më vonë se brenda 10 (dhjetë) ditë punë nga data e dorëzimit të tij në KQZ.
6. Partia politike pjesëmarrëse në zgjedhje publikon raportin në faqen e saj zyrtare të internetit jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i tij në KQZ.

Neni 4

Vlerësimi *prima facie* i raportit financiar të fushatës zgjedhore nga KQZ

1. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dorëzimit të raportit financiar të fushatës zgjedhore në KQZ administrata e saj bën verifikimin *prima facie* duke:
 - a. verifikuar elementët formale sipas modeleve të miratuara me këtë vendim;
 - b. kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën për dhurimet sipas modelit KQZ 04-12, shtojcës nr. 5 që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe nëse dhurimi i fondeve jopublike është transferuar në llogaritë e posaçme të hapura për këtë qëllim;
2. Nëse nga verifikimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore i bërë sipas pikës 1 të këtij neni rezultojnë mangësi, atëherë KQZ ia kthen raportin subjektit zgjedhor për plotësim. Jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e kthimit për plotësim subjekti zgjedhor ka detyrimin të ridërgoj në KQZ raportin me plotësimet e kërkuara sëbashku me shpjegimet kur është rasti.
3. KQZ publikon në faqen e saj zyrtare të internetit raportin sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 3 të këtij akti.

Neni 5

Auditimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore”

1. Auditimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore kryhet nga ekspertë kontabël të licencuar, të cilët nga këtu e vijim në këtë akt referohen si “auditues ligjorë”. Audituesit ligjorë caktohen nga KQZ sipas procedurave të përcaktuara me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Audituesi ligjorë auditon raportin financiar të fushatës zgjedhore brenda 30 ditëve nga dita marrjes së tij prej KQZ-së. Auditimi kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet e auditimit financiar të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
3. Audituesi ligjorë ka të drejtë të:
 - a) intervistojë persona dhe subjekte të ndryshme duke mbajtur edhe një procesverbal;
 - b) marrë informacion nga autoritetet përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - c) këqyrë dokumente që lidhen me këto verifikime të thelluara pranë zyrave përkatëse të partisë politike;
 - d) marrë çdo lloj informacioni apo të dhënë tjetër nga institucionet shtetërore, bankat apo persona të tretë;
 - e) të kërkoj dhe të marrë informacion nga raportet e dorëzuara nga monitoruesit e fushatës zgjedhore;
 - f) të kërkojë dhe të marrë informacion nga raportet e dorëzuara në KQZ nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).
4. Në përfundim të auditimit, audituesi ligjorë i dorëzon subjektit zgjedhor dhe KQZ-së projekt raportin e auditimit, i cili përmban gjetje dhe rekomandime përkatëse, sipas modelit KQZ 03-13, në shtojcën nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi. Nëse për arsye të përligjura audituesi ligjorë nuk dorëzon në KQZ projekt-raportin brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, KQZ mundet të shtyjë afatin e dorëzimit të tij deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe për jo më shumë se 3 (tre) herë.
5. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja në dorëzim e projekt raportit të auditimit, subjekti zgjedhor ka të drejtën ti paraqes audituesit ligjorë dhe KQZ shpjegime (kundërshtime/objeksione), në lidhje me projekt raportin.
6. Audituesi ligjorë, pasi merr shpjegimet nga subjekti zgjedhor, i shqyrton ato dhe në rast se i vlerëson të arsyeshme ndryshon ose plotëson pjesët përkatëse të raportit të auditimit duke i pasqyruar ato në raportin përfundimtar.

7. Audituesi ligjorë i dorëzon subjektit zgjedhor dhe KQZ-së raportin përfundimtar të auditimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së shpjegimeve nga subjekti zgjedhor. Raporti përfundimtar hartohet sipas modelit KQZ 03-14, në shtojcën nr. 7 bashkëlidhur këtij vendimi.
8. Nëse raporti financiar për fushatën zgjedhore është paraqitur në KQZ nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar, audituesi ligjorë bënë vlerësimet për raportin po nëpërmjet kësaj platforme në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga KQZ.

Neni 6

Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore dhe krahasimet me raportet e auditimit

1. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar të auditimit në KQZ administrata e KQZ-së bënë vlerësimin e integruar nëpërmjet kryqëzimit të të dhënave të këtij raporti me ato të raportit financiar të fushatës zgjedhore të dorëzuar nga subjekti zgjedhor duke:
 - a. krahasuar të dhënat me gjetjet dhe konkluzionet në raportin e audituesit ligjorë, të përzgjedhur nga KQZ-ja për të audituar raportin financiar të fushatës zgjedhore, si dhe çdo informacion të marrë gjatë hetimit administrativ si rezultat i ankesave, kërkesave apo denoncimet lidhur me shkeljet e mundshme të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - b. kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën për dhurimet dhe nëse dhurimi i fondeve jopublike është transferuar në llogaritë e posaçme të hapura për këtë qëllim;
 - c. verifikuar nëse fondet e përfituara dhe shpenzuara nga kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatë zgjedhore janë deklaruar në raportin e dorëzuar nga subjekti zgjedhor;
 - d. rillogaritur totalin e shpenzimeve të deklaruara gjatë fushatës zgjedhore dhe duke e krahasuar atë me kufirin e lejuar për financim të subjekteve zgjedhore të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi.
 - a. marrë çdo lloj informacioni apo të dhënë tjetër nga institucionet shtetërore, bankat apo persona të tretë.

2. Në përfundim të verifikimit nga kryqezimi i të dhënave nga raportet e monitoruesve, raporti financiar i fushatës zgjedhore, raporti përfundimtar i auditimit, si dhe informacione të tjera të administruara, administrata e KQZ-së harton raportin e gjetjeve dhe ia dorëzon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore brenda 30 ditëve nga koha e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga koha e mbylljes së procedurës së verifikimit.
4. Nëse nga krahasimi ndërmjet raportit financiar të subjekteve zgjedhore me raportin përkatës të auditimit për fushatën zgjedhore, rezulton se ka mospërputhshmëri, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve autorizon me shkrim kryerjen e verifikimeve të thelluara. Për qëllime të verifikimit, nëse e gjykon të arsyeshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve urdhëron një riauditim nëpërmjet një audituesi të ri nga lista e ekspertëve kontabël të licencuar (audituesve ligjorë). Audituesi i ri, për përgatitjen e raportit ka ndjek të njëjtat procedura të përcaktuara në nenin 5 të këtij vendimi.
5. Audituesi i ri harton një raport përfundimtar dhe e dorëzon në KQZ brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
6. Pas përfundimit të procesit të riauditimit, administrata e KQZ-së i paraqet Komisionerit një relacion përfundimtar ku parashtron gjetjet nga verifikimi dhe kontrolli, si dhe rekomandimet për masa të mëtejshme. Komisioneri, brenda 48 (dyzet e tetë) orësh nga marrja e relacionit, miraton me shkrim gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura ose në rast se nuk bie dakord me to bën refuzimin përkatës me shkrim, duke arsyetuar refuzimin për të dhënë miratimin.

Neni 7

Financieri i partisë politike dhe përgjegjësitë e tij

1. Partia politike pjesëmarrëse në zgjedhje duhet të caktojë një financier për raportimin financiar të fushatës zgjedhore.
2. Partia politike e regjistruar në zgjedhje ndërpret marrëdhëniet me financierin dhe emëron një financier të ri në rastet kur financieri:
 - a) bëhet i paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;

- b) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
 - c) jep dorëheqjen;
 - d) është në kushtet e konfliktit të interesave në raport me KQZ;
 - e) vdes.
3. Partia politike pjesëmarrëse në zgjedhje njofton me shkrim KQZ për ndryshimin e financierit brenda 5 (pesë) ditëve nga emërimi i financierit të ri.
4. Financieri i partisë politike pjesëmarrëse në zgjedhje mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë e tij duke:
- a. administruar veprimtarinë financiare të fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor;
 - b. regjistruar të gjitha transaksionet financiare të bëra për qëllim të fushatës zgjedhore, si dhe gjurmon çdo shpenzim dhe/ose kontribut në natyrë;
 - c. ndjekur hapjen dhe deklarimin e llogarisë bankare të posaçme, në momentin e regjistrimit si subjekt zgjedhor dhe siguron që dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë të bëhet vetëm në llogarinë bankare të posaçme;
 - d. mbledhur dhe arkivuar/ruajtur për një periudhë 7 vjeçare, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbështetëse përfshirë faturat, mandat pagesat, deklaratat bankare, informacionin që mbështet vlerësimin e dhurimeve në natyrë dhe deklaratat e dhuruesve. Regjistri i dhurimeve mbahet sipas modelit KQZ 02-09, shtojcës nr. 8 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - e. administruar të gjithë veprimtarinë financiar për fushatën zgjedhore të kandidatëve të listave shumemërore, të vënë në dispozicion nga këta të fundit;
 - f. dorëzuar raportin financiar të fushatës zgjedhore duke u kujdesur që të jetë i saktë, i plotë dhe i depozituar në kohë në KQZ;
 - g. siguruar që t'i kthehet përgjigje në mënyrë të plotë dhe në kohë çdo kërkesë për informacion të paraqitura nga audituesi ligjorë apo KQZ-ja.
5. Financieri kontrollon të gjitha burimet e të ardhurave, duke u siguruar se:
- a. origjina e të ardhurave, atyre monetare dhe në natyrë, është nga dhurues të ligjshëm dhe të lejuar nga ligji;
 - b. vlerësimi i dhurimeve në natyrë është kryer si duhet;
 - c. nuk janë tejkaluar kufijtë në dhurime nenit 92/2, pikat 4 e Kodit Zgjedhor.

6. Financieri mban përgjegjësi për dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët e listave shumëmemërore, kandidatët për kryetar bashkie me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se nuk ka pasur mundësi ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati.

Neni 8

Përgjegjësitë e kandidatëve të listave shumëmemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie të propozuar nga partia politike/koalicioni

1. Kandidati i listës shumëmemërore dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrimin të informojë në mënyrë periodike financierin e partisë politike/financierin e partisë udhëheqëse të koalicionit, mbi të ardhurat dhe shpenzimet e kryera prej tyre, si dhe ka detyrimin të ndjekë udhëzimet e këtij të fundit.
2. Kandidati i listave shumëmemërore, si dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrim të dorëzojë tek financieri brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zgjedhjeve raportin financiar të shoqëruar me dokumentet justifikues mbi fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera prej tij gjatë fushatës zgjedhore.
3. Kandidati i listave shumëmemërore dhe kandidati për kryetar bashkie dokumenton dhe regjistron vlerat e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
4. Kandidati i listave shumëmemërore dhe kandidati për kryetar bashkie duhet të deklarojë në momentin e regjistrimit në zgjedhje llogarinë e posaçme bankare, nëse planifikon të pranojë dhurime për fushatën e tij.

Neni 9

Përgjegjësitë e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit

1. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit duhet të deklarojë në momentin e regjistrimit në zgjedhje, llogaritë e posaçme bankare.

2. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit dokumenton dhe regjistron vlerat e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë e tij duke:
 - h. administruar veprimtarinë financiare të fushatës zgjedhore;
 - i. regjistruar të gjitha transaksionet financiare të bëra për qëllim të fushatës zgjedhore, si dhe gjurmon çdo shpenzim dhe/ose kontribut në natyrë;
 - j. ndjekur hapjen dhe deklarimin e llogarisë bankare të posaçme, në momentin e regjistrimit si subjekt zgjedhor dhe siguron që dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë të bëhet vetëm në llogarinë bankare të posaçme;
 - k. mbledhur dhe arkivuar/ruajtur të gjithë informacionin dhe dokumentet mbështetëse përfshirë faturat, mandat pagesat, deklaratat bankare, informacionin që mbështet vlerësimin e dhurimeve në natyrë dhe deklaratat e dhuruesve. Regjistri i dhurimeve mbahet sipas modelit KQZ 02-09, shtojcës nr. 8 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - l. dorëzuar raportin financiar të fushatës zgjedhore duke u kujdesur që të jetë i saktë, i plotë dhe i depozituar në kohë në KQZ;
 - m. siguruar që t'i kthehet përgjigje në mënyrë të plotë dhe në kohë çdo kërkesë për informacion të paraqitura nga audituesi ligjorë apo KQZ-ja.
4. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit kujdeset që të gjitha shpenzimet e fushatës zgjedhore të kryhen sipas nenit 92/2, pika 5 e Kodit Zgjedhor.
5. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit apo financieri i caktuar prej tij mbart të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë nen.

Neni 10

Shfuqizime

1. Vendimin nr. 9, datë 29.1.2022, i Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, shfuqizohet.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe.

Neni 12

Ankimi

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Periudha e raportimit: 6 muaj para fillimit të fushatës zgjedhore dhe periudha e fushatës zgjedhore

Emri i Partisë Politike	PARTIA E SHEMBULL1	
Shkronjat Nistore	PSH	
Kryetari i Partisë Politike		
Tel/Cel		
Email		
NIPT		
Adresa		

Emri I Financierit	Mbiemri I Financierit	Nënshkrimi
Emri		

Tel/Cel I Financierit	Email I Financierit	NID I Financierit
0690000000		

Emri I Aprovuesit	Mbiemri I Aprovuesit	Nënshkrimi

Ky format raportimi konsiston në seksionet e mëposhtme:

1. Detaje & Përmbledhje
- 2.a Të ardhura - Financime publike
- 2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike
- 2.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
- 2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike
3. Huatë dhe Kreditë
4. Shpenzimet e partisë
- 5.a Raportet e kandidatëve për Kryetarë të Qeverisjes Vendore
- 5.b Raportet e kandidatëve të listave shumëemërore për njësitë e qeverisjes vendore
6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni.
Tabela "**Referenca**" nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet dorazi tek Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm në KQZ dhe gjithashtu me email në adresën:
Valbona.Ballgjini@kqz.gov.al

1. Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
a. Totali i të ardhurave nga fondet publike	ALL	-
b. Totali i të ardhurave nga persona fizike	ALL	-
c. Totali i të ardhurave nga persona juridike	ALL	-
d. Totali i të ardhurave nga kandidatët për kryetarë	ALL	-
e. Totali i të ardhurave nga kandidatët e listave	ALL	-
e. Totali i të ardhurave të krijuara nga vetë partia	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i shpenzimeve të bëra nga partia	ALL	-
b. Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët për kryetarë	ALL	-
c. Totali i shpenzimeve të bëra nga kandidatët e listave	ALL	-
d. Totali i shpenzimeve indirekte	ALL	-
e. Totale të papaguara/detyrime financiare	ALL	-

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

2.a Të ardhura - Financime publike

Shuma e fondeve publike të përfituara në përputhje me nenet 88 dhe 89 të Kodit Zgjedhor

- a Fondi i marrë nga Buxheti i Shtetit (sipas nenit 88)
Data e marrjes së fondit nga Buxheti i Shtetit
Diferenca e kthyer (nëse ka, sipas nenit 88, pika 7)
Data e kthimit të diferencës
- b Kompensimi financiar paszgjedhor (neni 89)
Data e marrjes së kompensimit financiar paszgjedhor

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike

A. Aktiviteti nga i cili keni krijuar të ardhura	B. Shuma e të ardhurave	C. Data në të cilën janë depozituar të ardhurat	D. Kodi bankar i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat	E. Numri i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat	F. Të ardhura të krijuara nga:	G. Emri i degës (nëse është i aplikueshëm)	H. Përshkrimi
--	-------------------------	---	--	--	--------------------------------	--	---------------

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

3. Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3. Huatë dhe Kreditë

											Termit	
A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (rreshti 1)	D. Adresa e huadhënësit (rreshti 2)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huasë/kredisë	H. Shuma e huasë/limiti i kredisë	I. Data e fillimit të huasë/kredisë	J. Norma e interesit	K. Data e shlyerjes	L. Kolaterali i ofruar	

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

4. Shpenzimet e partisë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 4.
Shpenzimet e partisë

											Shpenzimet e zyrës elektorale	Mitingjet e fushatës			Media		Materiale promovionale/Media Sociale/Sondazhe/Publikime dhe reklama/Transport/Reklamime në natyrë/Konsulencë									
A. Kategoria e shpenzimeve	B. Shitësi/furnizuesi	C. Nr identifikimit të faturës	D. Data e faturës	E. Data e pagesës	F. Shuma e paguar	G. Shuma e papaguar (nëse ka)	H. Metoda e kryerjes së pagesës	I. Shpjegimi	J. Shpenzimi kryer nga:	K. Dega e partisë	L. Sipas bashkive	M. Vendi i mitingut	N. Ambienti	O. Data e mitingut	P. Lloji i medias	R. Përshkrimi	S. Përshkrimi									

FINANCIERI
Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI
Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

5.a Raportet e kandidatëve për Kryetarë të Qeverisjes Vendore

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 5.a Raportet e kandidatëve për Kryetarë të Qeverisjes Vendore

A. Bashkia	B. Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetarë sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	C. Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetarë sipas secilës njësi të qeverisjes vendore
------------	---	--

Belsh
Berat
Bulqizë
Cërrik
Delvinë
Devoll
Dibër
Divjakë
Dropull
Durrës
Elbasan
Fier
Finiq
Fushë Arrëz
Gjirokastrë
Gramsh
Has
Himarë
Kamëz
Kavajë
Këlcyrë
Klos
Kolonjë
Konispol
Korçë
Krujë
Kuçovë
Kukës
Kurbini
Lezhë
Libohovë
Librazhd
Lushnjë
Malësi e Madhe
Maliq
Mallakastër
Mat
Memaliaj
Mirditë
Patos
Peqin
Përmet
Pogradec
Polican
Prrenjas
Pukë
Pustec
Roskovec
Rrogozhinë
Sarandë
Selenicë
Shijak
Shkodër
Skrapar
Tepelenë
Tiranë
Tropojë
Ura Vajgurore
Vau i Dejës
Vlorë
Vorë

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

5.b Raportet e kandidatëve të listave shumëemërore për njësitë e qeverisjes vendore

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 5.b Raportet e kandidatëve të listave shumëemërore për njësitë e qeverisjes vendore

A. Bashkia	B. Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	C. Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas seciles njësi të qeverisjes vendore
------------	--	---

Belsh
Berat
Bulqizë
Cërrik
Delvinë
Devoll
Dibër
Divjakë
Dropull
Durrës
Elbasan
Fier
Finiq
Fushë Arrëz
Gjirokastrë
Gramsh
Has
Himarë
Kamëz
Kavajë
Këlcyrë
Klos
Kolonjë
Konispol
Korçë
Krujë
Kuçovë
Kukës
Kurbini
Lezhë
Libohovë
Librazhd
Lushnjë
Malësi e Madhe
Maliq
Mallakastër
Mat
Memaliaj
Mirditë
Patos
Peqin
Përmet
Pogradec
Polican
Prrenjas
Pukë
Pustec
Roskovec
Rogozhinë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

A. Mitingjet e fushatës

B. Kategoritë e shpenzimeve për mitingje

C. Kostoja

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Lloji_i_zgjedhjeve	Lloji_dhurimit	Statusi_i_dhuresit	Metoda_e_dhurimit	Lloji_i_shpenzimit	Lloji_i_medias	Po_Jo	Data_më_e_hershm	Marrë_nga	Aktiviteti_që_ka_krijuar_të_ardhura	Të_pa_raportueshme	Kategoria_e_shpenzimit	Kategoria_shpenzimeve_të_fushatës	Lisiamitingjevedinamike	Kryer_nga	Qarku
Parlamentare Lokale	Dhurime monetare Dhurime në natyrë Të ardhura të krijuara nga subjekti	Person fizik Person juridik Entitet juridik	Para në dorë/cash Çek bankar Transfertë bankare Kartë krediti/debiti	Mitingje/tubime dhe aktivitete Materiale promocionale Media Media sociale Sondazhe Botime/Publikime Transporti Konsulenca Reklamime në natyrë Shpenzime zyre elektorale Shpenzimet administrative	TV Radio Printime Online	Po Jo	01-01-17	Zyra qendrore Dega	Shtypi i printuar Shitja e publikimeve Dhënia me qera Interesa bankare Kuotat e anëtarësisë Transfertë nga llogaritë e partisë e tjera (specifikoji në kolonën e fundit)	Të dhënat e meposhtme Konfirmoj se nuk kemi zëra për të raportuar	Zerat e shpenzimeve monetare Shpenzime të papaguara Detyrime financiare	Shpenzime për vendin/ambientin Shpenzime për zbavitje/argëtim Shpenzime për pajisje Shpenzime për pije Shpenzime për reklama/promocion Shpenzime për transport Shpenzime administrative		Zyra qendrore Dega	Belsh Berat Bulqizë Cërrik Delvinë Devoll Dibër Divjakë Dropull Durrës Elbasan Fier Finiq Fushë Arrëz Gjirokastrë Gramsh Has Himarë Kamëz Kavajë Këlcyrë Klos Kolonjë Konispol Korçë Krujë Kuçovë Kukës Kurbini Lezhë Libohovë Librazhd Lushnjë Malësi e Madhe Maliq Mallakastër Mat Memaliaj Mirditë Patos Peqin Përmet Pogradec Polican Prenjas Pukë Pustec Roskovec Rrogozhinë Sarandë Selenicë Shijak Shkodër Skrapar Tepelenë Tiranë Tropojë Ura Vajgurore Vau i Dejës Vlorë Vorë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët e listave shumëmemërore të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Emri i Partisë Politike	
Shkronjat Nistore	
Emri i kandidatit	
Bashkia	
Tel/cel	
Email	
Adresa	

Emri i Financierit	Mbimri i Financierit	Nënshkrimi

Tel/Cel i Financierit	Email i Financierit	NID i Financierit

Emri i Aprovuesit	Mbimri i Aprovuesit	Nënshkrimi

Ky format tip konsiston në seksionet e mëposhtme:

1. Përmbledhje financiare
- 2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike
- 2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
- 2.c Huatë dhe Kreditë
3. Shpenzime

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni.
Tabela "**Referenca**" nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet tek Kryefinancieri i Partisë tuaj brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike	Shkronjat Nistore
Emri i Kandidatit	Bashkia

1. Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
b. Totali i të ardhurave nga persona fizike	ALL	-
c. Totali i të ardhurave nga persona juridike	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i pagesave të bëra	ALL	-
b. Totali i shpenzimeve indirekte	ALL	-
c. Totale të papaguara/detyrime financiare	ALL	-

FINANCIERI

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

Emri i Kandidatit

Bashkia

2.c Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2.c Huatë dhe Kreditë

											Termat
A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (rreshti 1)	D. Adresa e huadhënësit (rreshti 2)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huasë/kreditë	H. Shuma e huasë/limitit i kreditë	I. Data e fillimit të huasë/kreditë	J. Norma e interesit	K. Data e shlyerjes	L. Kolaterali i ofruar

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike
Emri i Kandidatit

Shkronjat Nistore
Bashkia

3. Shpenzime

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3. Shpenzime

A. Kategoria e shpenzimeve	B. Shitësi/furnizuesi	C. Nr identifikimit të faturës	D. Data e faturës	E. Data e pagesës	F. Shuma e paguar	G. Shuma e papaguar (nëse ka)	H. Metoda e kryerjes së pagesës	I. Shpjegimi	J. Sipas bashkive	K. Pershkrimi	L. Lloji i medias	M. Pershkrimi

FINANCIERI
Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI
Emër Mbiemër Firmë

Lloji i zgjedhjeve	Lloji dhurimit	Statusi i dhuruesit	Metoda e dhurimit	Lloji i shpenzimit	Lloji i medias	Po Jo	Data më e hershme	Marrë nga	Aktiviteti që ka krijuar të ardhura	Të pa raportueshme	Kategoria e shpenzimit	Kategoria shpenzimeve të fushatës	Llistattingjeve dinamike	Bashkia
Parlamentare Lokale	Dhurime monetare Dhurime në natyrë Të ardhura të krijuara nga subjekti	Person fizik Person juridik Entitet juridik	Para në dorë/cash Çek bankar Transfer të bankare Kartë krediti/debiti	Mitigjje/tubime dhe aktivitet Materiale promoconale Media Media Sociale Sondazhe Botime/Publikime Transporti Konsulenca Reklamime në natyrë Shpenzime zyre elektorale Shpenzimet administrative	TV Radio Printime Online	Po Jo	01-01-17	Zyra qëndrore Dega Kandidati	Shitja e printuar Shitja e publikimeve Dhënia me qera Interesa bankare Kuotat e anëtarësisë Të tjera (specifikoni në kolonën e fundit)	Të dhënat e mëposhtme Konfirmoj se nuk kemi zëra për të raportuar	Zërat e shpenzimeve monetare Shpenzime të papaguara Detrimet financiare	Shpenzime për vendin/ambientin Shpenzime për zhvillje/argëtim Shpenzime për pajisje Shpenzime për pajë Shpenzime për reklama/promocion Shpenzime për transport Shpenzime administrative		Bashkia Beftah Berat Buldizë Cërrik Delvinë Devoll Dibër Durrës Durrës Elbasan Fier Finiq Fushë Arëz Gjirokastrë Gramsh Has Himarë Kamëz Kavajë Këlcyrë Klos Kolonjë Korçë Krujë Kuçovë Kukës Kurbin Lezhë Libohovë Librazhd Lushnjë Malësi e Madhe Maliq Mat Matiashtër Memaliaj Mirditë Patos Peqin Përmet Pogradec Polican Prrenjas Pukë Pustec Roskovec Rrogozhinë Sarandë Selencë Shijak Shkodër Skrapar Tepelenë Tiranë Tropojë Ura Vajgurore Vau i Dejës Vlorë Vorë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për
kandidatët për kryetarë bashkie të organeve të qeverisjes

Emri i Partisë Politike	
Shkronjat Nistore	
Emri i kandidatit	
Bashkia	
Tel/cel	
Email	
Adresa	

Emri i Financierit	Mbimemri i Financierit	Nënshkrimi

Tel/Cel i Financierit	Email i Financierit	NID i Financierit

Emri i Aprovuesit	Mbimemri i Aprovuesit	Nënshkrimi

Ky format tip konsiston në seksionet e mëposhtme:

1. Përmbledhje financiare
- 2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike
- 2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
- 2.c Huatë dhe Kreditë
3. Shpenzime
4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni.
Tabela "**Referenca**" nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet tek Kryefinancierit i Partisë tuaj brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike	Shkronjat Nistore
Emri i Kandidatit	Bashkia

1. Përmbledhje financiare

Totali i të ardhurave:	ALL	-
b. Totali i të ardhurave nga persona fizike	ALL	-
c. Totali i të ardhurave nga persona juridike	ALL	-
Totali i huave:	ALL	-
Totali i shpenzimeve:	ALL	-
a. Totali i pagesave të bëra	ALL	-
b. Totali i shpenzimeve indirekte	ALL	-
c. Totale të papaguara/detyrime financiare	ALL	-

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike
Emri i Kandidatit

Shkronjat Nistore
Bashkia

2.c Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2.c Huatë dhe Kreditë

											Termit		
A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (rreshti 1)	D. Adresa e huadhënësit (rreshti 2)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huasë/kredisë	H. Shuma e huasë/limiti i kredisë	I. Data e fillimit të huasë/kredisë	J. Norma e interesit	K. Data e shlyerjes	L. Kolaterali i ofruar		

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Emri i Kandidatit

Shkronjat Nistore

Bashkia

4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

A. Mitingjet e fushatës

B. Kategoritë e shpenzimeve për mitingje

C. Kostoja

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Lloji_i_zgjedhjeve	Lloji_dhurimit	Statusi_i_dhurimit	Metoda_e_dhurimit	Lloji_i_spenzimit	Lloji_i_medias	Po_Jo	Data_më_e_hershm	Marrë_nga	Aktiviteti_që_ka_krijuar_të_ardhura	Të_pë_raportueshme	Kategoria_e_spenzimit	Kategoria_spenzimeve_të_fushatës	Listamitingjevedinamike	Qarku
Parlamentare Lokale	Dhurime monetare Dhurime në natyrë Të ardhura të krijuara nga subjekti	Person fizik Person juridik Entitet juridik	Para në dorë/cash Çek bankar Transfer të bankare Kartë krediti/debiti	Mitingje/tubime dhe aktivite Materiale promovionale Media Media Sociale Sondazhe Botime/Publikime Transporti Konsulenca Reklamime në natyrë Shpenzime zyre elektorale Shpenzimet administrative	TV Radio Printime Online	Po Jo	01-01-17	Zyra qëndrore Deja Kandidati	Shiptari i printuar Shënimet e publikimeve Dhënja me qera Interesa bankare Kuotat e anëtarësisë Të tjera (specifikoni në kolonën e fundit)	Të dhënat e mëposhtme Konfirmoj se nuk kemi zëra për të raportuar	Zërat e shpenzimeve monetare Shpenzime të papaguara Detyrime financiare	Shpenzime për vendim/ambientin Shpenzime për zbatim/argëtim Shpenzime për pajisje Shpenzime për pije Shpenzime për reklama/promocion Shpenzime për transport Shpenzime administrative		Bajsh Bierat Bulqizë Çerrik Delvinë Devoll Dibër Dijakë Dropull Durrës Elbasan Fier Finiq Fushë Arrëz Gjirokastrë Gramsh Has Himare Kamëz Kavajë Këlcyrë Klis Kolonjë Konispol Korçë Krujë Kucovë Kukës Kurbini Lezhë Libohovë Librazhd Lushnjë Mat Mati e Madhe Matig Mallakastër Mat Memaliaj Mirditë Patos Peçin Përmet Pogradec Polican Pristinë Pukë Pustec Rostovec Rrogozhinë Sarandë Selenicë Shijak Shkodër Skrapar Tepelenë Tiranë Tropojë Ura Vajcurora Vau i Dejës Vlorë Vorë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për "Kandidatin e paraqitur nga një grup zgjedhësish" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Emri i kandidatit	
Bashkia	
Tel/cel	
Email	
Adresa	

Emri I Financierit	Mbimri I Financierit	Nënshkrimi

Tel/Cel I Financierit	Email I Financierit	NID I Financierit

Emri i Aprovuesit	Mbimri I Aprovuesit	Nënshkrimi

Ky format raportimi konsiston në seksionet e mëposhtme:

1. Përmbledhje financiare
- 2.a Të ardhura - Financime publike
- 2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike
- 2.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
3. Huatë dhe Kreditë
4. Shpenzimet
5. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni.
Tabela "Referenca" nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet dorazi tek Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm në KQZ dhe gjithashtu me email në adresën:
